

Ministrja Nagavci priti Sekretarin Gjeneral të EVBB, Theodore Grassos

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci ka pritur në takim Sekretarin Gjeneral të Asociacionit Evropian të Instituteve për Aftësim Profesional (EVBB), Theodore Grassos, me të cilin ka biseduar për përmirësimin e cilësisë në AAP dhe mundësitë për bashkëpunim për krijimin e një fuqie punëtore me shkathtësitë që kërkon tregu i punës.Â

Ministrja Arbërie Nagavci me këtë rast ka rikujtuar se, MASHTI është përgjegjëse për pjesën e AAP-së formale, ku në kuadër të saj veprojnë 68 shkolla profesionale, ku 62 nga shkollat menaxhohen nga DKA-të, derisa 6 prej tyre menaxhohen nga AAAPARr.Â

Â

Ndër të tjera, ministrja Nagavci theksoi se, për sigurinë e nxënësve gjatë punës praktike, këtë vit janë ndarë mbi 3 milionë euro dhe se janë duke marrë model shtetet më të zhvilluara.Â

Â

Në këtë drejtim, ministrja Nagavci tha se janë nënshkruar edhe kontratat e para me 16 nxënës të Qendrës së Kompetencës në Skënderaj dhe me këtë rast ka filluar implementimi në praktikë i mësimit dual, që ka qenë edhe një nga premtimet e Qeverisë së Kosovës.Â

Â

Ndërsa, Sekretarin Gjeneral i EVBB, Theodore Grassos theksoi faktin se kërkesa e bizneseve për punëtorë të kualifikuar është e madhe.Â

Â

Ndryshe, objektiva kryesore e punës së EVBB-së është përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional në vendet Evropiane, krijimi i mundësive dhe kushteve për një fuqi punëtore mobile me shkathtësi të duhura profesionale sipas kërkesave të tregut Evropian.Â

Â

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) në Kosovë që nga fillimi i vitit 2016 është anëtare e Asociacionit Evropian të Instituteve për Aftësim Profesional (EVBB) me seli në Bruksel e cila është organizatë ombrellë, anëtare të të cilës janë organizata dhe institucione të ndryshme shtetërore nga vendet e ndryshme Evropiane, institute koordinuese të arsimit dhe ofruesit e arsimit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.